



**UK International
Development**

Partnership | Progress | Prosperity

DOKUMENT QËNDRIMESH

**Mbi Lëvizjet Demografike gjatë
procesit parazgjedhor të
zgjedhjeve parlamentare të
datës 11 maj**



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
COMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

DOKUMENT QËNDRIMESH

Mbi Lëvizjet Demografike Gjatë Procesit Parazgjedhor Të Zgjedhjeve Parlamentare të Datës 11
Maj 2025

Publikuar më 18 Gusht 2025



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Përgatiti:

Znj, Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Emanuel Xhindi, Asistent Ligjor dhe Asistent Projektesh, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike: Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar në partneritet me Institutin e Studimeve Politike (ISP), Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

PO BOX no.1752; Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al



Komiteti Shqiptar i Helsinkit

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Metodologjia

Metodologjia e përgatitjes së këtij dokumenti mbështetet në një *modus operandi* praktik, me synim nxjerrjen e konkluzioneve dhe sugjerimeve racionale për procesin e administrimit të zhvendosjes së popullsisë në juridiksionet e ndryshme të zyrave të gjendjes civile, përgjatë periudhës parazgjedhore.

Në përputhje me Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) i është drejtuar me kërkesa për informacion trembëdhjetë bashkive¹ objekt monitorimi të periudhës parazgjedhore (Janar- Maj 2025), për sa i takon këtyre pikave kyçe:

- Sa shtetas janë regjistruar si rrjedhojë e transferimeve në zyrat e gjendjes civile në juridiksionin e Bashkisë së monitoruar? Cilat janë Bashkitë prej nga kanë ardhur?
- Sa persona rezultojnë se janë ç’regjistruar nga zyrat e gjendjes civile në juridiksionin e bashkisë përkatëse?
- Cila është procedura ligjore e ndjekur për transferimet e reja dhe ç’regjistrimet si rrjedhojë e largimeve? A disponon Bashkia juaj informacion të segreguar mbi kriteret mbi bazën e të cilit kanë ndodhur këto ndryshime? Nëse po lutem na i vendosni në dispozicion.

Në vijim të marrjes së informacionit për pikat e mësipërme, autorët e këtij dokumenti kanë analizuar, nëpërmjet një përqasjeje kritike, mënyrën e administrimit të regjistrimeve të lëvizjeve demografike, si një garanci për inflacionin artificial të votuesve në juridiksione të caktuara administrative në Republikën e Shqipërisë. Kjo pike paraqet interes, për arsye të pretendimeve të përsëritura në vite të lëvizjeve të pajustificuara demografike gjatë periudhës parazgjedhore, me qëllim “ndryshimin e përkatësisë elektorale” të një zone të pafavorshme për ndonjë subjekt politik.

¹ Malësi e Madhe, Shkodër, Durrës, Tiranë, Pogradec, Berat, Kukës, Lezhë, Dibër, Korçë, Elbasan, Fier, Lezhë, Vlorë, Gjirokastrë



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Përmbledhje Ekzekutive

Mbajtja e rregullt e arkivave dokumentive të lëvizjeve demografike të popullsisë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sidomos gjatë periudhës parazgjedhore, paraqet një rëndësi të vecantë, në kuptim të ofrimit të garancive të nevojshme për shmangien e atyre lëvizjeve, të shumtën e rasteve të dirigjuara nga burime financiare dhe njerëzore në terren të subjekteve më të fuqishme politike, të cilat mund të ndikojnë në “prirjen politike” në nivel rrethi, dhe rrjedhimisht, prekin rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare. Në vijim të kësaj logjike, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1243 dt. 11.12.2009 “Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit, e procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna, dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve”, në zbatim të Ligjit nr. 10129 dt. 11.05.2009 “Për gjendjen civile” parashikon një detyrim të shprehur për mbajtjen e rregullt të arkivit elektronik, me të gjitha dokumentet mbështetëse të kërkuara nga sistemi e-Albania për ndryshimin e vendbanimit personal dhe familjar.

Në këtë kontekst, e cmojmë si esencial detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të siguruar përditësimin e vazhdueshëm të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile me dokumentacionin arkivor justifikues të këtyre lëvizjeve.

Për më tepër, autorët e këtij dokumenti mbajnë qëndrimin se zyrat rajonale të gjendjes civile, në mënyrë që të sigurojnë një koherencë të plotë të monitorimit të lëvizjeve demografike brenda vendit, duhet të kenë akses në dokumentet justifikuese të disponuara nga qytetarët për ndryshimin e vendbanimit të tyre.

Edhe pse nuk është objekt direkt i këtij dokumenti, autorët nuk mund të rrinë pa theksuar gjendjen alarmante të disa prej njësive administrative në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat, shpeshherë, sic do të shihet edhe në vijim të përmbajtjes, kanë shënuar shumë më tepër largime sesa ardhje. Nga studimi edhe në terren i konstruktiv praktik të tërësive administrative të këtyre zonave, posaçërisht, afërsinë me njëra tjetrën dhe përfundimisht ngritjen e Qendrave të Votimit (QV), rezulton se në disa raste, disa Qendra Votimi me më pak se 300 votues për atë juridiksion, duhet të shkrihen, dhe votuesit e asaj QV-je duhet t’i bashkohen një tjetër Qendër Votimi, për respektim të nenit 62 pika 7 e Kodit Zgjedhor².

² 7. Kur një zonë qendër votimi ka më pak se 300 zgjedhës, kryetari i njësive së qeverisjes vendore vendos që ajo t’i bashkohet zonës së qendrës së votimit me numër më të madh zgjedhësish, më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor. Si rregull, qendra e re e votimit nuk është më larg se 5 km nga qendra e votimit që shkrihet për zonat rurale. Në rast se nuk është e mundur të zbatohen të dy kriteret e mësipërme, kriteri i numrit minimal të zgjedhësve ka përparësi. Numri i qendrës së votimit të shkriretë pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit. KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret dhe procedurat për bashkimin e qendrave të votimit, në përputhje me këtë pikë.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Konkretisht, për Njësinë Administrative Pult, Qarku Shkodër, zyra e Kryetarit të Bashkisë, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kanë marrë vendim për mos t'u shkrirë një Qendër Votimit, për arsye të largësisë së madhe të QV-së tjetër, dhe vështirësisë së qytetarëve për aksesimin e saj.

Për arsye të tilla, konstatojmë se nevojitet një rishikim i kujdesshëm i kriterit të numrit të votuesve në juridiksione të caktuara, duke krijuar hapësira për debat institucional lidhur me ndryshime të mundshme në Kodin Zgjedhor.




Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Gjetje statistikore lidhur me lëvizjet demografike nëpër njësitë administrative objekt monitorimi gjatë procesit parazgjedhor

Bashkia Gjirokastrë (Njësia Administrative Gjirokastrë)

Në njësinë administrative të Gjirokastrës janë evidentuar 37 shtetas të ardhur dhe 78 të larguar. Ky raport përfaqëson një bilanc negativ të lëvizjeve, ku numri i largimeve është më shumë se dyfishi i atij të ardhjeve. Një fenomen i tillë ngre shqetësime të natyrës demografike dhe administrative, sidomos në prag të një procesi zgjedhor, duke rritur nevojën për monitorim të shtuar mbi motivet e këtyre lëvizjeve dhe ndikimin potencial në listat e votuesve.

**Lëvizjet në Njësinë Administrative
Gjirokastrë gjatë procesit parazgjedhor**



Bashkia Berat (Zyra e Gjendjes Civile Nr. 1, Nj.A. Sinjë, Nj.A. 004, Lagjja Nr. 12)


Në territorin e Bashkisë Berat janë evidentuar lëvizje të konsiderueshme në disa njësi të saj. Zyra Nr. 1 raportoi 19 shtetas të ardhur dhe 48 të larguar, ndërsa në Nj.A. Sinjë pati vetëm 2 ardhje kundrejt 13 largimeve.

Në Nj.A. 004 janë regjistruar 21 ardhje dhe 28 largime. Ndërkohë, në Lagjen Nr. 12 u evidentua një ekuilibër i plotë midis të ardhurve dhe të larguarve (22 persona në secilin drejtim), me 18 prej të ardhurve të identifikuar si votues.

Kjo e dhënë është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin zgjedhor, duke sugjeruar nevojën për verifikim të qëllimit dhe përputhshmërisë së këtyre ndryshimeve me ligjin.




Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE



Bashkia Shkodër

Zyra e Gjendjes Civile në Bashkinë Shkodër deklaroi se të dhënat e kërkuara për lëvizjet e shtetasve nuk mund të siguroheshin, duke u justifikuar me faktin se procedurat përkatëse kryhen në mënyrë elektronike dhe nuk arkivohen. Megjithatë, ky arsyetim bie ndesh me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1243, datë 11.12.2009, i cili e përcakton qartë ruajtjen e dokumentacionit në arkivin elektronik të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, megjithatë, të dhënat statistikore duhet të jenë të aksesueshme për çdo zyrë përkatëse të gjendjes civile. Refuzimi për të dorëzuar të dhënat krijon mungesë transparence dhe cenon integritetin e procesit.



Bashkia Kukës


Edhe Bashkia Kukës paraqiti të njëjtën përgjigje si Bashkia Shkodër, duke mos ofruar të dhëna mbi lëvizjet në zyrat e gjendjes civile. Justifikimi mbi mungesën e të dhënave për lëvizjet e kryera është në kundërshtim të hapur me kuadrin ligjor në fuqi, i cili ngarkon institucionet me detyrimin për të ruajtur dhe aksesuar të dhënat përmes arkivit elektronik. Ky refuzim administrativ ndikon negativisht në transparencën institucionale dhe mund të krijojë hije dyshimi mbi saktësinë e listave zgjedhore.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE


Bashkia Durrës

Nga të dhënat e dorëzuara prej kësaj bashkie, rezulton që janë larguar 344 shtetas dhe janë regjistruar 503 shtetas të ardhur ose që kanë kryer ndryshim njësie si pasojë e dokumentacionit. Ky bilanc paraqet një shtesë të konsiderueshme të popullsisë së regjistruar, çka kërkon vëmendje të veçantë për verifikimin e ligjshmërisë së dokumenteve dhe qëllimit të transferimeve në kontekstin parazgjedhor.



Bashkia Dibër (Nj.A. Peshkopi)

Zyra e Gjendjes Civile në njësine administrative Peshkopi raportoi 70 ardhje dhe 226 largime, ku shumica e lëvizjeve kanë ndodhur përmes lejeve të banimit dhe migrimit martesor. Ky disproporcion tregon për një fluks të lartë largimesh, që mund të ndikojë në përbërjen demografike të njësisë dhe në listat e votuesve. Emrat dhe të dhënat personale të individëve janë përfshirë në përgjigje, çka rrit nevojën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe verifikimin e integritetit të procedurës.



Bashkia Korçë (Nj.A. Korçë, Mollaj, Voskop, Voskopoje)


Lëvizjet në këtë bashki janë të shpërndara në disa njësi administrative:



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE


- **Korçë (qendra):** 43 ardhje, 75 largime
- **Mollaj:** 0 ardhje, 3 largime
- **Voskop:** 13 ardhje, 3 largime
- **Voskopojë:** 0 ardhje, 5 largime

Në tërësi, kemi të bëjmë me një balancë negative, ku një numër i lartë largimesh nga zona urbane të Korçës reflekton lëvizje potencialisht të lidhura me motivime të ndryshme administrative apo sociale. Këto të dhëna kërkojnë analizë më të thelluar për të zbuluar nëse ka raste të zhvendosjeve të qëllimshme për ndikim zgjedhor.



Bashkia Pogradec

Nga të dhënat e raportuara, Bashkia Pogradec ka regjistruar një bilanc pozitiv me 80 ardhje dhe 46 largime. Kjo prirje tregon për një rritje të popullsisë së regjistruar në zonën përkatëse, që mund të ndikojë në ndryshime të përfaqësimit zgjedhor dhe rrit nevojën për verifikim të dokumentacionit të përdorur për ndryshimin e vendbanimit.






Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE


Bashkia Lezhë (Të gjitha njësitë)

Në këtë bashki janë raportuar 174 ardhje dhe 113 largime, duke krijuar një balancë pozitive. Rritja e popullsisë së regjistruar në mënyrë të përqendruar në prag të zgjedhjeve mund të ketë ndikim në dinamikën elektorale dhe kërkon që institucionet përgjegjëse të garantojnë legjitimitetin e çdo regjistrimi të ri në përputhje me ligjin.



Bashkia Fier (Të gjitha njësitë)

Nga raportimi rezulton që Bashkia Fier ka regjistruar 293 ardhje dhe 315 largime, me një bilanc negativ të vogël. Megjithëse lëvizjet janë të shumta, shpërndarja e tyre në të gjitha njësitë administrative sugjeron një dinamikë të përgjithshme të popullsisë. Verifikimi i qëllimit të këtyre lëvizjeve është thelbësor për të siguruar saktësinë e listës së votuesve dhe për të shmangur manipulimet zgjedhore.





Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Përfundime thelbësore

Nga shqyrtimi i përgjithshëm i mënyrës së monitorimit të lëvizjeve demografike dhe operabilitetit të veprimtarisë rregulluese të zyrave të gjendjeve civile në bashkitë objekt monitorimi nga KSHH, na ka rezultuar se zyrat e gjendjeve civile, nuk kanë një mekanizëm kontrolli për sa i përket legjitimitetit të këtyre lëvizjeve. Në të vërtetë, rezulton se ky funksion është lënë krejtësisht në dorë të përditësimit të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile me dokumentet justifikues të kërkuar sipas ligjit- pra, është lënë në kompetencën e vetme të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Faktikisht, ky *modus operandi* është në kundërshtim me Ligjin nr. 10129, “Për Gjendjen Civile”, dt. 11.05.2009, i ndryshuar, neni 22 i të cilit parashikon:

Neni 22

Dokumentacioni për vërtetimin e vendbanimit dhe ndryshimit të tij

1. Zyra e Gjendjes Civile e regjistron deklarin e vendbanimit ose banesës për përdorim 7 vetjak apo familjar të shtetasit kur ai paraqet dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose një kontratë apo dokument tjetër të ligjshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës.

2. Këshilli i Ministrave përcakton dokumentacionin e nevojshëm që vërteton vendbanimin apo banesën për përdorim vetjak ose familjar të shtetasit, si dhe mënyrën e administrimit të këtij dokumentacioni nga zyra e gjendjes civile

Siç mund të shihet, ka qenë vullneti i ligjvënësit që zyrat vendore të gjendjes civile, duke qenë më afër me komunitetin dhe lëvizjet dinamike-demografike brenda juridiksioneve të tyre, të kenë një *rol mbikëqyrës* më të theksuar- kjo, për të thënë, në një nivel më *mikro-* të lëvizjeve nga dhe drejt juridiksioneve të tyre administrative.

Më tej, në përputhje me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1243 dt. 11.12.2009 “Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna, dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve”, dale në zbatim të Ligjit nr. 10129 dt. 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, zyrat vendore të gjendjes civile duhet që të realizojnë një arkivim fizik të dokumentacionit justifikues për deklarin dhe ndryshimin e vendbanimit. Në eventualitete të caktuara të ndërhyrjeve të jashtme në regjistrat digjitalë arkivues, këto organe duhet të sigurojnë dokumentimin e plotësimit të kushteve ligjore për shfrytëzimin e mundësive të ndryshimit të vendbanimit zyrtar të shtetasve.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në vijim të kësaj logjike, KSHH vlerëson se zyrat vendore të gjendjes civile, duke qenë organet përgjegjëse për hartimin periodik të listave të zgjedhësve³, duhet t'i kushtojnë një rëndësi më të madhe monitorimit dhe verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore për deklarimin dhe ndryshimin e vendbanimit të qytetarëve, për arsye se në rast se këto kushte nuk janë plotësuar, në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike, zgjedhësit e transferuar në juridiksione të caktuara nuk mund të përfshihen në listen e zgjedhësve.

Mungesa e një verifikimi të qartë të plotësimit të kushteve ligjore për deklarimin dhe ndryshimin e vendbanimit, do të shkaktonte edhe një rritje artificiale të alokimit të kostove të përgjithshme për njoftimin e zgjedhësve, në përputhje me neni 52, pika 5 e Kodit Zgjedhor⁴.

³ Neni 51, **Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë**, pika 4 e Kodit Zgjedhor parashikon: *Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre. Publikimi bëhet në ambientet e zyrave të gjendjes civile ose në ambientet pranë tyre me akses të lirë për publikun.*

⁴ 5. Shpenzimet për njoftimin, sipas këtij neni, mbulohen nga ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile. Fondi përkatës u shpërndahet njësisë të qeverisjes vendore në raport me numrin e zgjedhësve që ka çdo njësi e qeverisjes vendore